


Analfabetizmi në Kosovë

Në Kosovë, shkrim-leximi është çështje e gjinisë dhe e moshës. Kjo tregohet qartë në tabelën më poshtë, ku analfabetizmi paraqitet në shkallë më të ulët për popullatën mashkullore. Meshkujt analfabetë kanlojnë mbi 10 përqind vetëm tek ata mbi moshën 65 vjeç, ndërsa shënimet përkatëse tek femrat kalojnë mbi 50 përqind. Por te grupet më të reja analfabetizmi është në zhdukje e sipër dhe kështu është duke u ngushtuar hapësira e shkallës së analfabetizmit midis meshkujve dhe femrave.¹

Figura 10.1: Shkalla e analfabetizmit dhe gjinia



Burimi: Anketë Demografike dhe Socio-ekonomike 1999

Sipas Anketës Demografike dhe Socio-ekonomike të realizuar në vitin 1999, mesatarisht mbi moshën 15 vjeç, 2.3 përqind e burrave dhe 10.2 e femrave janë analfabetë në Kosovë. Siç shihet më lartë ka dallime të mësha në moshë dhe gjini por analfabetizmi është një çështje që varet nga vendi ku jeton personi. Ai është zakonisht më i lartë në trevat rurale se sa në ato urbane. Gati 14 përqind e grave që jetojnë në treva rurale definoohen si analfabete, ndërsa pjesëmarrja përkatëse e burrave analfabetë është me 10 pika të përqindjes më e ulët.

Tabela 10.1: Analfabetizmi sipas gjinisë dhe rajonit në përqindje

	Femra 15+	Meshkuj 15+	Gjithsej 15+
Rurale	13.7	3.7	8.8

¹ Në nëntor të vitit 1999 në anketën Demografike e Socio-ekonomike ishte një pyetje për analfabetizëm. Pyetja ishte: A dini shkrim-lexim? Alternativat e përgjigjes ishin po ose jo. Në figurën 10.1 dhe tabelën 10.1 abalfabetizmi është definuar si pjesëmarrje që i përgjigjet jo në këtë pyetje. Në anketën demografike dhe shëndetësore 2003, parashtrohet pyetja: a mund të shkruani dhe lexoni? Aletnativat e përgjigjes ishin po dhe jo. Në tabelat 10.2 dhe 10.4 analfabetizmi është përcaktuar për pjesëmarrësit që janë përgjigjur me jo në pyetje.

Urbane	7.1	1.2	4.3
Gjithsej	10.2	2.3	6.5

Burimi: Anketa Demografike dhe Socio-ekonomike 1999

Anketa për matjen e Standardit të Jetesës (AMSJ/LSMS 2002) ka konstatuar pa befasi se analfabetizmi duket të jetë i përqëndruar midis grupeve të vjetra (të moshave mbi 55 vjeçe) dhe bie në 5 përqind te popullata e moshës 45 vjeçe e më të re. Analfabetizmi në atë anketë është definuar si mundësi për të lexuar, madje dhe me vështirësi (Banka Botërore 2001)). Këto ecuri tregojnë se përfaqësojnë grupet Shqiptarëve të Kosovës dhe të Serbëve të Kosovës. Mirpo sipas AMSJ200 një shtim i rrëprijshëm i analfabetizmit midis grupeve të reja të “grupeve etnike të reja” ka ngjarë gjatë dekadës së kaluar. Duke rënë në numra njëshifror grupet e moshës 26-45, analfabetizmi midis këtyre grupeve tjera etnike përsëri është shtuar shumë rrëpishëm, duke arritur në 22 përqind te grupi i moshës 16-17 dhe rreth 15 përqind te grupi i moshës 18-25.

Në Anketën Demografike dhe Shëndetësore (ADSH 2003) është parashtruar pyetja për analfabetizëm. Shifrat në tabelën 10.2 ndryshojnë pak nga tabela 10.1, por parimi është i njëjtë. Ndryshimi në shifra është i natyrshëm varësisht nga thurja e pyetjes, referencave të ndryshme dhe gabimet e mostrës.²

Tabela 10.2: Analfabetizmi sipas gjinisë dhe rajonit 2003, në përqindje

	Femra 15+	Meshkuj 15+	Gjithsej 15+
Rurale	13.4	3.8	8.7
Urbane	10.4	2.3	6.5
Gjithsej	12.5	3.4	8.1

Burimi: Anketa Demografike dhe Shëndetsore 2003

Sipas ADSH 2003, 92 përqind e popullsisë më lartë mbi 15 vjeç dijnë shkrim lexim. Shifrat nga anketat e tjera tregojnë shtrirje të njëjtë.

Tabela 10.3: mesatarja e viteve të shkollimit 2003

	Femra 15+	Meshkuj 15+	Gjithsej 15+
Rurale	8.2	10.3	9.3
Urbane	9.9	11.2	10.6
Gjithsej	8.7	10.6	9.7

Burimi: Anketa Demografike dhe Shëndetsore 2003

Parimi është i njohur mirë, meshkujt në trevat urbane janë më të arsimuar dhe femrat në trevat rurale janë më pak të arsimuara.

² në përgjithësi shkalla e shkirm-leximit e marrë më 1999 mund të jetë më e lartë për shkak të definimeve më të gjera që janë përdorur, që rezultojnë në përfshirjen e disa përgjegjësve të cilët mund të lexojnë por jo të shkruajnë. Definimet e UNESCO shkirm-leximi për një person definohet ai i cili di të shkruaj të lexoj fjalitë e shkurta e me kuptim.

Taebila 10.4: Shkrim leximi sipas gjinisë dhe moshës 2003, në përqindje

Age	Females 15+	Males 15+	Total 15+
15-39	2.7	0.9	1.8
40-64	13.7	1.9	7.7
65-	71.7	25.3	49.9
Total	12.5	3.4	8.1

Burimi: Anкета demografike dhe Shëndetsore 2003

Konkluzionet janë të qarta. Në Kosovë shkrim-leximi është çëshje e gjinisë dhe e moshës, por poashtu dhe se ku jeton. Shkrim leximi është zakonisht më i lartë në trevat rurale se sa në ato urbane. Gati 14 përqind e femrave që jetojnë në trevat rurale definoohen si analfabetë, përderisa pjesëmarrja e meshkujve analfabetë është 10 pika të përqindjes më e ulët. Meshkujt në treva urbane janë më të arsimuar dhe femrat në trevat rurale janë më pak të arsimuara.

Referencat

UNFPA, ESK, IOM (2001): *Situata demografike, sociale, ekonomike dhe shëndeti riprodaktiv në Kosovë pas konfliktit të vitit 1999*. Rezultatet e anketës së ekonomive familjare, nëntor 1999- shkurt 2000. Janar 2001.

Banka Botërore (2001): *Vlerësimi i Varfërisë, Kosovë*. Vëllimi I: Raporti kryesor, 20 dhjetor 2001. Bazuar në AMSJ 2000.

ESK, UNICEF, TADEST (2002): *Sstatistikat e Arsimit në Kosovë 2001*. Versioni 2, Korrik 2002.

ESK (2004): Tabela nga *ADSH 2003*. Shkurt 2004.